

L I G J I

I MATJES DHE I KADASTRIT TË TOKAVE

I — PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Matja e tokave, hartimi i kadastrit të tokave, si dhe mirëmbajtja dhe përtirja e tyre bëhet në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar me këtë ligj dhe me dispozitat e nxjerra në bazë të tij.

Neni 2

Matja e tokave (në tekstin e mëtejme: matja) bëhet me qëllim të përcaktimit të të dhënave të nevojshme për paraqitjen horizontale dhe të lartësisë së terrenit të territorit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Krahina) me qëllim të shfrytëzimit të këtyre të dhënave për qëllime ekonomike, teknike, shkencore dhe administrative, si dhe për nevojat tjera të organeve, të organizatave të punës së bashkuar, të organizatave e të bashkësive tjera vetëqeverisëse dhe të qytetarëve.

Neni 3

Në bazë të matjes së kryer hartohet kadastr i tokave.

Kadastr i tokave është evidenca themelore për tokën dhe objektet në të, që shfrytëzohen për qëllime ekonomike, administrative dhe statistikore, për hartimin e librave të tokave, për përcaktimin e ardhurave kadastrale, për mbajtjen e evidencës pasurisë së paluajtshme në pronësinë shoqërore, në pronësinë e qytetarëve, për hartimin e planeve pësinore dhe për nevojat e tjera të organeve, të organizatave të punës së bashkuar, të organizatave bashkësive të tjera vetëqeverisëse dhe të qytetarëve.

Neni 4

Matja dhe kadastrit i tokave janë me interes të veçantë për Krahinë.

Neni 5

Punët e matjes dhe të kadastrit të tokave janë në kompetencë të organeve të Krahinës dhe të komunave, në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 6

Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë, përkatësisht organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë në lëmin e matjes dhe të kadastrit të tokave dhe të mirëmbajtjes së tyre kryen edhe punët e administratës dhe profesionale të caktuara me këtë ligj.

Neni 7

Matja dhe hartimi i kadastrit të tokave bëhet në bazë të programeve afatmesme dhe vjetore të punëve.

Programin afatmesëm të punëve e nxjerr Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome i Kosovës, ndërsa programin vjetor të punëve e nxjerr Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë me pëlqimin e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës.

Neni 8

Zhvillimin e punimeve në kryerjen e matjes dhe të hartimit të kadastrit të tokave e bën Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë nëpërmjet organizatave të punës së bashkuar të themeluara për kryerjen e punëve të gjeodezisë (në tekstin e mëtejme: organizatat e gjeodezisë).

Në kushtet e përcaktuara me këtë ligj organizatat e punës së bashkuar mund t'i kryejnë punët e gjeodezisë për nevojat e veta dhe punët e gjeodezisë në kuadër të veprimtarisë së vet.

Punimet në kryerjen e matjes dhe të hartimit të evidencave të veçanta për tokën për nevojat e mbrojtjes popullore mund t'i zhvillojnë organet kompetente të mbrojtjes popullore.

Punët në kryerjen e matjes dhe të hartimit të kadastrit të tokave, si dhe punët në mirëmbajtjen e matjes dhe të kadastrit të tokave janë punë me interes të veçantë shoqëror.

Neni 9

Dokumentacionin e matjes dhe të kadastrit të tokave e ruajnë dhe e mirëmbajnë Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë, përkatësisht organi komunal i administratës, kompetent për punët e gjeodezisë.

Mënyrën e ruajtjes dhe të shfrytëzimit të dokumentacionit, të matjes dhe të kadastrit të tokave e përcakton Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 10

Kontrolli në të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave është i lirë, në qoftë se për disa të dhëna me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe, dhe mund të bëhet në lokalet zyrtare të organit të administratës, kompetent për punët e gjeodezisë që mban evidencë për këto të dhëna.

Organi nga paragrafi 1 i këtij neni ka për detyrë që me kërkesën e palës së interesuar të lëshojë dokumentet për provat e përmbajtura në të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave (certifikata, kopjet e planit, përshkrimet dhe ekstraktet e gjendjes etj.).

Përshkrimet, kopjet dhe të dhënat tjera të matjes dhe të kadastrit të tokave të marra nga organi kompetent për punët e gjeodezisë nuk mund t'i je-

pen për shfrytëzim organeve tjera, organizatave të punës së bashkuar dhe qytetarëve.

Neni 11

Planet, elaborati i gjeodezisë, operati kadastral, si dhe pjesët e tyre nuk mund të qitën jashtë lokalet të organit kompetent të administratës, kompetent për punët e gjeodezisë, përkatësisht nga lokalet e Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë.

Neni 12

Organet, organizatat e punës së bashkuar dhe organizatat dhe bashkësitë tjera vetëqeverisëse, qytetarët dhe personat civilë-juridikë në punët e kryerjes së punëve ndërtimore dhe komunale, si dhe në punët juridike për të cilat nevojiten të dhënat e matjes dhe përshkruese për pasuri të paluajtshme, kanë për detyrë t'i shfrytëzojnë të dhënat zyrtare të matjes dhe të kadastrit të tokave.

Gjykatat dhe organet tjera të cilat vendosin për ndryshimin e të drejtave të pronësisë dhe të të drejtave tjera në pasurinë e paluajtshme, kanë për detyrë që në vendimet me të cilat vendosin për këtë t'i shënojnë pasuritë e paluajtshme sipas të dhënave të matjes dhe të kadastrit të tokave dhe këto akte, pas plotëfuqishmërisë së tyre, t'i dërgojnë organit komunal të administratës, kompetent për punët e gjeodezisë.

Konstituimi dhe mirëmbajtja e të gjitha evidencave zyrtare për pasuri të paluajtshme duhet të bazohet në të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave.

Në rastet nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni shënimi i pasurisë së paluajtshme bëhet në bazë të kopjes së planit të organit komunal të administratës, kompetent për punët e gjeodezisë.

II — MATJA DHE KADASTRI I TOKAVE

1. Matja

Neni 13

Matja përfshinë:

a) vënien dhe caktimin e rrjetës astronomike — gjeodezike, gravimetrike, trigonometrike dhe niveluese, si dhe përpunimin e matjeve të kryera në këto rrjeta (punët themelore të gjeodezisë).

Punët themelore të gjeodezisë përbëjnë bazën unike të matjes dhe të punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta.

b) vënien dhe caktimin e bazës së gjeodezisë për matjen dhe përpunimin e matjeve të kryera në këto rrjeta,

c) rilevimin fotogrametrik nga ajri dhe rilevimet tjera të gjeodezisë me qëllim të hartimit të planeve dhe të hartave origjinale,

d) punët e gjeodezisë lidhur me komasacionin e tokave,

d) rilevimet e gjeodezisë të ujrave dhe të objekteve nëntokësore,

dh) hartimin dhe ribotimin e hartës kryesore shtetërore,

e) ribotimin e planeve dhe përpunimin e tyre të mëtejme hartografik.

Neni 14

Përpunimi i të dhënave të fituara me matje bëhet në projekcionin e Gaos — Krigeri të zonave të merdianeve. Gjerësia e çdo zone është tri (3) shkallë të gjerësisë gjeografike. Çdo zonë përbën sistem të veçantë të koordinatave.

Për pikat e matjes caktohen koordinatat e rrafshita këndërrëjtë në njërin prej sistemeve të koordinatave nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 15

Punët në vënien dhe caktimin e rrjetës astronomike-gjeografike, trigonometrike, gravimetrike dhe niveluese dhe përpunimi i matjeve të kryera në këto rrjete, bëhet sipas procedurës me metodat e matjes dhe me instrumente, si dhe sipas mënyrës së përpunimit të të dhënave të matjes, që të sigurohet saktësia e nevojshme e cila mundëson që rezultatet e punëve të shfrytëzohen si bazë e obligueshme për të gjitha punët e matjes dhe punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta.

Me qëllim të orientimit të rrjetës trigonometrike sipas pozitës gjeografike për një numër pikash dhe anësh të kësaj rrjete caktohen koordinatat astronomike dhe azimutet (pika e Laplasit).

Saktësia e punëve në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni caktohet me dispozita të veçanta të Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë.

Neni 16

Rrjeta trigonometrike përfshin tërë territorin e Krahinës dhe ndahet në katër rنده.

Rrjeta trigonometrike e rendit të parë, së bashku me pikat e Laplasit përbën rrjetën astronomike gjeodezike.

Për qytetet dhe vendbanimet me karakter urban vihen rrjetat e veçanta të gjeodezisë.

Për të gjitha pikat e rrjetës trigonometrike caktohen lartësitë — kotat mbidetare.

Neni 17

Rrjeta gravimetrike shërbon si bazë për matjet gravimetrike të cilat bëhen me qëllim të saktësisë më të madhe të vënies dhe orientimit të rrjetës astronomike-gjeodezike, për caktimin e pozitës midis vetës të sipërfaqeve të gjeodelëve dhe të elipsoidëve, për llogaritjen e lartësisë së reperëve të nivelimeve me saktësi të lartë dhe shërben si bazë për matje gravimetrike të cilat bëhen për nevojat e kërkimeve gjeologjike, studimin e fushës së gravitacionit dhe për nevojat tjera shkencore.

Rrjeta gravimetrike ndahet në rrjetë kryesore dhe plotësuese. Rrjeta kryesore gravimetrike siguron shkallën unike dhe nivelin e fushës së gravitacionit.

Neni 18

Bazën për paraqitjen e relievit të sipërfaqes së tokës, si dhe për të gjitha punët teknike me rastin e të cilave shfrytëzohen lartësitë mbidetare ose caktohen ndryshimet e lartësive, e përbën rrjeta niveluese. Rrjeta niveluese shërben për përcjelljen e lëvizjes së sipërfaqes së epërme të tokës, si dhe për përpunimin e elementeve për përcjelljen e tërmeteve katastrofale.

Rrjeta niveluese ndahet në rrjetën niveluese me saktësi të lartë, në rrjetën e nivelimit precizë dhe në rrjetën e nivelimit teknik.

Në qytetet dhe në vendbanimet me karakter urban vihet rrjeta e veçantë niveluese.

Për të gjitha pikat (reperët) e përhershme të rrjetit nivelues llogariten lartësitë e kotat mbidetare. Kotat llogariten në sistemin unik të lartësive, ndërsa baza është lartësia mbidetare e reperit normal i caktuar në Magjaj.

Për të gjitha pikat e rrjetit nivelues caktohen Koordinatat.

Neni 19

Me qëllim të hartimit të origjinaleve të planeve dhe të hartës kryesore shtetërore bëhet rilevimi i detajeve.

Rilevimi i detajeve përfshin punët në mbledhjen e të dhënave përkatëse të matjes dhe përshkrues për paraqitjen horizontale dhe vertikale të tokave, për pozitën, formën, kulturat, shfrytëzuesit e parce-

leve, për pasqyrën topografike të tokave në pikëpamje të relievit dhe të objekteve natyrore dhe artificiale, për emërimet gjeografike dhe emërimet tjera, si dhe të dhënat për ujërat dhe objektet nëntokësore.

Neni 20

Rilevimi i detajeve bëhet: sipas metodës ortogonale, metodës polare dhe metodës fotogrametrike.

Bazën për rilevimin e detajeve e përbën rrjeta poligonometrike, rrjeta e poligonit, rrjeta e lindjes dhe rrjeta e pikave lidhëse, të cilat mbështeten në rrjetën trigonometrike dhe në rrjetën niveluese.

Neni 21

Origjinalet e planeve dhe të hartave përpilohen në bazë të të dhënave të rilevimit të detajeve të mbledhura edhe të përpunuara në elaboratin e gjeodezisë.

Në hartimin e planeve këtu edhe punët e llogaritjes së sipërfaqeve.

Neni 22

Planet hartohen në njërën nga këto shkallë: 1:500, 1:1000, 1:2000, 1:2500 dhe 1:5000.

Harta shtetërore përpilohet në shkallë 1:5000 dhe 1:10000.

Harta sipas rregullit, përpilohet me përpunimin hartografik të planeve dhe punohet në sistemin e shumë fletëve pa ndërprerje.

Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë cakton shkallën në të cilën përpilohen planet dhe hartat për disa raje dhe përcakton rendin e përpilimit të disa fletëve të hartave.

Neni 23

Përveç hartave nga neni 22 i këtij Ligji, punohen hartat topografike dhe pasqyrore në shkallë të vogla, si bazë për planifikim, paraqitje grafike dhe mbajtjen e statistikës dhe të evidencës.

Përmbajtjen, formën dhe shkallët e hartave nga paragrafi 1 i këtij neni i cakton Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë sipas mendimit të marrë më parë të Sekretariatit Krahinor të Mbrojtjes Popullore, Sekretariatit Krahinor të Ekonomisë, Sekretariatit Krahinor të Urbanizmit, Veprimtarisë Komunale dhe të Banesave, Entit Krahinor të Planifikimit Shoqëror, Entit Krahinor të Statistikës dhe të kuvendeve të komunave të interesuara.

Neni 24

Planet dhe hartat shërbejnë për projektimin dhe bartjen e projekteve në tokë dhe si material hartues për përpilimin e hartave destinuese.

Të dhënat e rilevimit të detajeve, si dhe përpilimi i planeve dhe i hartave duhet të jenë të afta që çdo herë në bazë të tyre të mund të bëhet rilevimi i pikave dhe i gjendjes në tokë siç ka qenë me rastin e rilevimit paraprak.

Neni 25

Organizata e gjeodezisë, organizata e punës së bashkuar dhe organizata e bashkësia tjetër vetëqeverisëse që i ka përpiluar planet e hartës dhe elaboratin e gjeodezisë vërteton me origjinalin e planit të hartës dhe të elaboratit të gjeodezisë se janë përpiluar sipas dispozitave në fuqi.

Planet, hartat dhe elaboratet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shfrytëzohen kur t'i vërtetojë Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë.

Neni 26

Origjinalet e planeve dhe të hartave (origjinalet arkivore) shërbejnë për fitimin e kopjeve të tyre dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Kopja e planit dhe e hartës (origjinali punues) sipas mënyrës së përpunimit dhe të saktësisë, duhet t'i përgjigjet origjinalit arkivor, në kufijtë e saktësisë grafike.

Origjinalet punuese në të cilat bëhet bartja e ndryshimeve të bëra në tokë domosdo shfrytëzohen si origjinale arkivore me rastin e çdo shumëzimi të mëtejme.

Origjinali arkivor dhe elaboratet e punëve themelore të gjeodezisë ruhen në arkivin e Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë, ndërsa pjesët tjera të elaboratit të matjes në organin komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë.

Neni 27

Pronari, personi i cili realizon të drejtën e disponimit dhe mbajtësi tjetër (në tekstin e mëtejme: shfrytëzuesit) të tokave në rajonin në të cilin bëhet rilevimi, kanë për detyrë, me qëllim të sigurimit të saktësisë së matjes që me shpenzimet e veta brenda afatit të cilit e cakton organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë t'i shënojnë me figura të dukshme dhe të përhershme kufijtë e tokave dhe të objekteve të cilat gjenden në to.

Neni 28

Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë ka për detyrë që së paku 60 ditë më parë ta informojë Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit komunal për fillimin e matjes së tokave në territorin e komunës përkatëse.

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë kujdeset që shfrytëzuesit në mënyrë të drejtë dhe me kohë t'i shënojnë kufijtë e tokave me figura të dukshme dhe të përhershme.

Shfrytëzuesit e tokave kanë për detyrë t'i lejojnë të hyjnë personat në toka dhe objekte personat, të cilët punojnë në punët e matjes, të kadastrit të tokave dhe të mirëmbajtjes së tyre, si dhe të lejojnë që ata të mund t'i vendosin figurat dhe shenjat me të cilat shënojnë pikat e matjes.

Në qoftë se me rastin e kryerjes së matjes shkaktohen dëme, shfrytëzuesit e tokave kanë të drejtë në kompensimin e dëmit nga organi, përkatësisht organizata, e cila ka kryer matjen.

Neni 29

Figura të matjes në pajtim me këtë ligj kuptohen të gjitha llojet e figurave me të cilat nën tokë dhe mbi tokë janë shënuar pikat e përhershme të gjeodezisë: rrjetat trigonometrike, gravimetrike-astro-nomike dhe nivelse të të gjitha radhëve, figurat e pikave të përhershme të gjeodezisë për rilevimin e detajeve, si dhe figurat me të cilat shënohen kufijtë e komunave kadastrale.

Shenja të matjes në pajtim me këtë ligj kuptohen aparatet dhe stabilimentet, të cilat shërbejnë për vëzhgimin ose vrojtimin e pikave të matjes (piramidat, skelet dhe sinjalet).

Neni 30

Organi komunal i administratës, kompetent për punët e gjeodezisë, përkatësisht organizata e gjeodezisë, e cila i ka vënë figurat ka për detyrë që pas vënies së figurave ose të shenjave të matjes, ta informojë shfrytëzuesin për llojin dhe vendin e figurave të vëna, përkatësisht të shenjave të matjes.

Neni 31

Figurat dhe shenjat me të cilat janë shënuar pikat e matjes nuk mund të prishen, të dëmtohen, e as të barten ose të transferohen pa autorizim.

Shfrytëzuesi në tokën e të cilit gjenden figurat ose shenjat nga paragrafi 1 i këtij neni, ka për detyrë që për çdo dëmtim, prishje, bartje ose transferim të figurave, përkatësisht të shenjave ta informojë organin komunal për punët e gjeodezisë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë.

Neni 32

Kur në tokën ose në objektin në të cilin gjenden figurat e matjes, ose në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre kryhen punët ndërtimore ose punët tjera, të cilat mund të dëmtojnë ose të prishin figurën ose të zvogëlojnë mundësinë e shfrytëzimit të tyre, kryesi i punëve ka për detyrë që së paku 15 ditë para fillimit të punëve për këtë ta lajmërojë organin komunal të administratës, kompetent për punët e gjeodezisë.

Në qoftë se për shkak të kryerjes së punëve nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të bartet figura, të prishet ose për shkak të punëve të zvogëlohet mundësia e shfrytëzimit të saj, investuesi i punëve i paguan të gjitha shpenzimet për rivënie e saj.

Neni 33

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë kujdeset për mbrojtjen e figurave dhe të shenjave të matjes dhe e informojë Drejtorinë Krahinore të Gjeodezisë për gjendjen e figurave dhe të shenjave të pikave trigonometrike dhe nivelse.

2. Kadastr i tokave

Neni 34

Kadastr i tokave përmban të dhënat për parcelat dhe objektet në tokë në pikëpamje të pozitës, formës, sipërfaqes, kulturës së tokave, bonitetit, klasës, të ardhurave kadastrale dhe shfrytëzuesve të tyre.

Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen, përpunohen ose evidencohen në kadastrin e tokave përkitazi me parcelën kadastrale.

Parcela kadastrale është pjesë e tokës e cila shfrytëzohet në mënyrë të njëjtë dhe i takon shfrytëzuesit të njëjtë.

Çdo parcelë kadastrale shënohet me numrin e parcelës dhe me emrimin e komunës kadastrale së cilës i takon parcela kadastrale.

Neni 35

Pozita dhe forma e çdo parcele kadastrale dhe objektet të cilat gjenden në të paraqiten në plane, ndërsa të dhënat tjera shënohen në regjistra dhe në pasqyra të veçanta.

Regjistrat dhe pasqyrat e veçanta përmbajnë të dhënat për sipërfaqet, kulturat, klasët, të ardhurat kadastrale dhe shfrytëzuesit e tokave për çdo parcelë në rajonin e një komune kadastrale dhe përbëjnë operatin kadastral të kësaj komune kadastrale.

Operati kadastral dhe origjinalet e punës në pikëpamje të të dhënave: sipas formës dhe sipërfaqeve të parcelave, kulturës, klasës, të ardhurave kadastrale dhe shfrytëzuesve, kanë cilësinë e librave publike.

Neni 36

Hartimi i kadastrit të tokave përfshin:

- a) përcaktimin e njësive kadastrale territoriale,
- b) klasifikimin kadastral dhe bonitetin e tokave,
- c) paraqitjen në shikim publik të të dhënave të matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave, dhe
- d) hartimin e operatit kadastral.

a) NJËSITË KADASTRALE TERRITORIALE

Neni 37

Njësitë kadastrale territoriale janë komuna kadastrale dhe rrethi kadastral.

Neni 38

Komuna kadastrale përfshin rajonin (ataria) e një vendbanimi.

Kuvendi i komunës, në qoftë se këtë e kërkojnë shkaqet e veçanta, për dy ose më tepër vende mund të formojë një komunë kadastrale, ose për rajonin e një vendbanimi të formojë disa komuna kadastrale.

Vendimin për rajonin dhe emërtimin e komunës kadastrale e merr kuvendi i komunës.

Neni 39

Kufijt e komunave kadastrale i cakton dhe i shënon komisioni i veçantë të cilin e formon kuvendi i komunës. Caktimi dhe shënimin i kufijve bëhet duke lënë figurat dhe shenjat kufitare në tokë dhe duke i përshkruar kufijt në procesverballin e përkufizimit.

Komisionin nga paragrafi 1 i këtij neni e përbëjnë nga dy qytetarë me vendbanim në rajonin e komunave kadastrale, kufijt e të cilave caktohen, dhe një ekspert i gjeodezisë.

Shpenzimet e punës të anëtarëve të komisionit i paguan kuvendi i komunës, i cili e ka formuar komisionin.

Kur kufijtë e komunave kadastrale përputhen me kufirin territorial të komunës, komisionin për caktimin e kufijve të atyre komunave kadastrale, me marrëveshje, e formojnë kuvendet e këtyre komunave.

Neni 40

Kontestet për kufijtë e komunave kadastrale në territorin e komunës së njëjtë i zgjidh kuvendi i komunës.

Kontestet për kufijtë e komunave kadastrale, të cilat njëkohësisht janë edhe kufijtë territoriale të bashkësisë shoqërore-politike, i zgjidhin organet, të cilat janë kompetente që t'i zgjidhin kontestet e kufijve territoriale të këtyre bashkësive.

Neni 41

Ndryshimin e kufijve të komunave kadastrale për të cilat është bërë matja dhe është hartuar operati kadastral, mund ta bëjë kuvendi i komunës sipas mendimit të marrë më parë të Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, kur kufijtë e komunave kadastrale përputhen me kufijtë territoriale të komunave, ndryshimin e kufijve e bën organi kompetent për ndryshimin e kufijve territorialë të komunave, në bazë të propozimit me marrëveshje të kuvendeve të komunave të interesuara.

Me ndryshimin e kufijve nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni përcillen ndryshimet e nevojshme në plane në elaboratin e gjeodezisë, si dhe hartohet operati i ri kadastral.

Mjetet për zbatimin e ndryshimeve nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni i sigurojnë kuvendet e komunave, të cilat kanë vendosur për ndryshimin e kufijve, përkatësisht kanë propozuar ndryshimin e kufijve.

Neni 42

Rrethi kadastral është njësi territoriale për klasifikimin kadastral të tokave.

Rrethin kadastral e përbëjnë dy ose më tepër komuna kadastrale territoriale të lidhura, të cilat paraqesin tërësi ekonomike me kushte të ngjashme natyrore dhe kushte tjera të prodhimit bujqësor.

Rrethet kadastrale i formon edhe rajoni i tyre, kurse emërtimet i cakton këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 43

Rajoni i rrethit kadastral mund të ndryshohet vetëm në qoftë se ndryshohen dukshëm kushtet, të cilat kanë ndikuar në caktimin e këtij rajoni.

b) KLASIFIKIMI KADASTRAL DHE BONITIMI I TOKAVE

Neni 44

Pas matjes së komunës kadastrale bëhet klasifikimi kadastral dhe bonitimi i tokave.

Klasifikimi kadastral i tokave bëhet në bazë të kushteve natyrore dhe ekonomike, të prodhimit të kulturës ekzistuese në tokë.

Me bonitim përcaktohet plleshmëria e tokave në bazë të veçorive të tyre natyrore, pa marrë parasysh mënyrën ekzistuese të shfrytëzimit të asaj toke (kulturave).

Njësia territoriale për bonitimin e tokave është territori i Krahinës.

Neni 45

Sipas kulturave, të gjitha tokat pjellore ndahen në: ara, kopshte, pemishte, vreshta, livadhe, kullosa, pyje e kallamishte dhe moçale.

Çdo njëra prej kulturave nga paragrafi 1 i këtij neni në rajonin e rrethit kadastral, sipas kushteve natyrore dhe ekonomike të prodhimit me rastin e klasifikimit mund të ndahet më së tepërmi në tetë klasë.

Sipërfaqet të cilat nuk mund të shfrytëzohen në bujqësi dhe pylltari kategorizohen në jopjellore.

Neni 46

Në qoftë se ndryshohet rajoni i rrethit kadastral do të bëhet klasifikimi i ri kadastral i tokave në rajonin e pjesës së ndryshuar ose në tërë territorin e rrethit kadastral, varësisht nga vëllimi i ndryshimit, konfiguracioni i terrenit dhe kushtet e tjera.

Kur ndryshimet në rajonin e rrethit kadastral janë të asaj natyre dhe vëllimi që nuk është e nevojshme të bëhet klasifikimi i ri kadastral në tërë territorin e rrethit kadastral, përcaktimi i klasëve të reja kadastrale, në pjesën e ndryshuar të rajonit, bëhet në kuadër të bazës ekzistuese për klasifikimin kadastral të tokave, përkatësisht të rrethit kadastral.

Neni 47

Klasifikimi kadastral i tokave bëhet sipas bazës së përcaktuar të klasifikimit.

Bazën e klasifikimit e përbëjnë tokat ekzeplare në rajonin e rrethit kadastral (mëtej tokat ekzeplare të rretheve), dhe ato për çdo klasë të kulturave ekzistuese të tokave, si suaza të klasëve për çdo kulturë të tokave për rajonin e çdo komune kadastrale.

Bazën e klasifikimit e përcakton Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë.

Neni 48

Në bazë dhe në kuadër të bazës për klasifikimin kadastral të tokave përcaktohen tokat ekzeplare të komunave për çdo kulturë dhe klasë ekzistuese në komunën kadastrale, sipas tokave të përcaktuara, për rrethin përkatës kadastral.

Neni 49

Tokat ekzeplare komunale caktohen për çdo kulturë dhe klasë ekzistuese në komunën kadastrale sipas tokave ekzeplare të caktuara të rretheve në rrethin kadastral. Tokat ekzeplare të rretheve janë njëkohësisht edhe të komunave në komunën kadastrale në të cilën gjenden.

Kaktimin e tokave ekzemplare të komunave dhe të klasifikimit kadastral në komunën kadastrale e bën komisioni për klasifikimin kadastral të tokave i cili përbëhet prej tre anëtarëve dhe numrit të njëjtë të zëvendësve. Komisionin për klasifikimin kadastral të tokave e formon Drejtoria Krahinore e gjeodezisë.

Komisionin e përbëjnë një inxhinier i diplomuar i bujqësisë me provimin e dhënë profesional sipas programit të përcaktuar për punëtorët në organet e administratës dhe dy prodhues bujqësorë, të cilët i zgjedhin tubimet e qytetarëve nga rajoni i komunës kadastrale për të cilin bëhet klasifikimi.

Neni 50

Të gjitha tokat e afta për bujqësi dhe prodhim pyjor me anën e bonitetit klasifikohen në të katër klasat e bonitetit në bazë të kritereve dhe të bazave për bonitetin që e përcakton Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë.

Bazën e bonitetit e përbëjnë tokat ekzemplare në territorin e Krahinës për çdo klasë të bonitetit.

Sipërfaqet jopjellore, si dhe sipërfaqet e kallamishteve dhe të mogleve nuk bonitohen.

Neni 51

Boniteti i tokave bëhet njëkohësisht me klasifikimin kadastral.

Ndarjen e tokave në klasë të bonitetit e bën eksperti bujqësor — anëtar i komisionit për klasifikimin kadastral të tokave. Njëkohësisht i rregjistrohet edhe të dhënat për shkallën e erozionit, vërshimet e përhershme dhe të kohëpaskohshme, qëndrimin e ujit dhe nivelin e ujërave nëntokësore.

Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni mund të bëhet edhe vetëm boniteti i tokave për rajonet në të cilat është bërë klasifikimi kadastral i tokave.

C) EKSPOZIMI PËR SHIKIM PUBLIK I TË DHËNAVE TË MATJES DHE I KLASIFIKIMIT KADASTRAL TË TOKAVE

Neni 52

Të dhënat e matjes të çdo komune kadastrale për sipërfaqet, kulturat, shfrytëzuesit e tokave, si dhe të dhënat për klasifikimin kadastral të tokave ekspozohen për shikim publik në rajonin e komunës kadastrale.

Neni 53

Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë cakton veçmas për çdo komunë kadastrale kohën në të cilën të dhënat e matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave ekspozohen për shikim publik.

Kohën dhe vendin e ekspozimit të të dhënave, në mënyrë të zakonshme e publikon organi komunal i administratës kompetent për punë të gjeodezisë. Ky organ ka për detyrë që në rajonin e komunës kadastrale të sigurojë lokalet e përshtatshme për punën e komisionit për ekspozim.

Neni 54

Punët lidhur me ekspozimin e të dhënave të matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave për shikim publik i kryen komisioni, të cilin e formon Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë (në tekstin e mëtejme: Komisioni për ekspozim).

Komisioni përbëhet prej tre anëtarëve dhe numrit të njëjtë të zëvendësve.

Komisionin e përbëjnë një ekspert i gjeodezisë dhe dy përfaqësues të rajoneve të komunës kadastrale për të cilën bëhet ekspozimi.

Përfaqësuesit e rajonit të komunës kadastrale i delegojnë tubimet e njerëzve punonjës dhe të qytetarëve.

Emërat e anëtarëve të komisionit për ekspozim nga komuna kadastrale ia dërgon Drejtoria Krahinore të Gjeodezisë organi komunal i administratës, kompetent për punët e gjeodezisë.

Neni 55

Komisioni për ekspozim ka për detyrë që me shkrim ta thërrasë çdo shfrytëzues të tokave me qëllim të kumtimit të të dhënave të matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave.

Komisioni për ekspozim çdo shfrytëzuesi të tokave, i cili i përgjigjet thirrjes me shkrim, do t'ia kumtojë të dhënat e matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave. Në qoftë se shfrytëzuesi është thirrur me kohë e në rregull e nuk i është përgjigjur thirrjes, do të konsiderohet se i janë komunikuar të dhënat e matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave, në atë rast, anëtarët e komisionit kanë për detyrë që t'i tregojnë të metat eventuale për të dhënat që ekspozohen.

Neni 56

Për të dhënat e matjes personi i interesuar mund të paraqesë kundërshtim brenda afatit prej 8 ditësh nga dita kur i janë kumtuar të dhënat.

Komisioni nga neni 54 i këtij ligji ka për detyrë ta shqyrtojë kundërshtimin dhe nëse konsideron se është me vend, do të bëjë ndryshimin përkatës të të dhënave të përcaktuara me matje. Ndryshimet e bëra i vërteton paraqitësi i kundërshtimit me nënshkrimin e vet në listën e regjistrimit.

Në qoftë se komisioni nuk e merr në konsiderim kundërshtimin, ka për detyrë që paraqitësit të kundërshtimit t'i lëshojë aktvendim për refuzimin e kundërshtimit.

Neni 57

Për të dhënat e matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave dhe për aktvendimin për refuzimin e kundërshtimit (neni 56 paragrafi 3) mund të parashtrihet ankesa brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Lidhur me ankesën nga paragrafi 1 i këtij neni vendos Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë.

C) HARTIMI I OPERATIT KADASTRAL

Neni 58

Operati kadastral hartohet për çdo komunë kadastrale në bazë të të dhënave të matjes dhe të klasifikimit kadastral të tokave, pas ekspozimit të këtyre të dhënave për shikim publik.

Hartimin e operatit kadastral Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë mund t'ia cëdojë organit tjetër, organizatës të punës së bashkuar dhe organizatës e bashkësisë tjetër vetëqeverisëse.

Neni 59

Organi, organizata e punës së bashkuar, organizata dhe bashkësia tjetër vetëqeverisëse, e cila e ka hartuar operatin kadastral ka për detyrë që atë t'ia dërgojë Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë për kontrollim dhe vërtetim.

Në qoftë se Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë konstaton se operati kadastral është hartuar në pajtim me dispozitat në fuqi, do ta vërtetojë operatin dhe do t'ia dërgojë organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë për shfrytëzim. Me operatin kadastral dërgohet edhe: përshkrimi i procesverbalit për përkufizimin e komunës kadastrale, të dhënat origjinale për rilevimin e detajeve

dhe llogaritjen e sipërfaqeve, skicat e detajeve, origjinalet e punës, planet dhe hartat, përshkrimi i regjistrave të tokave ekzemplare dhe përshkrimi i koordinatave, lartësive mbidetare (kotave) dhe përshkrimet e pozitës së pikave të rrjetës trigonometrike, niveluese dhe të pikave lidhëse.

Në aktvendim me të cilin e vërteton operatin kadastral, Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë cakton ditën e fillimit të aplikimit të tij.

III. MIRËMBAJTJA E MATJES DHE E KADASTRIT TË TOKAVE

Neni 60

Mirëmbajtja e matjes dhe e kadastrit të tokave përfshin:

— përcjelljen dhe përcaktimin e ndryshimeve të bëra në tokë, të cilat ndikojnë në të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave,

— bartjen në terren të të dhënave nga planet urbanistike dhe projektet urbanistike të cilat ndikojnë në të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave,

— bartjen e ndryshimeve të përcaktuara në elaboratin e matjes, në plane, në hartë dhe në operatin kadastral,

— përtrirjen e figurave të pikave të përhershme gjeodeze,

Përcaktimi, përpunimi dhe bartja e ndryshimeve bëhet saktësisht me metoda dhe sipas procedurës që janë përcaktuar për kryerjen e matjes dhe kadastrin e tokave.

Neni 61

Punët e mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave i kryen organi komunal i administratës, kompetent për punët e gjeodezisë.

Në kryerjen e punëve të mirëmbajtjes të matjes dhe të kadastrit të tokave organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë ka për detyrë që t'i mënjanojë të gjitha të metat dhe lëshimet e konstatuara në rilevimin e detajeve, në elaboratet e gjeodezisë, në plane, në hartë dhe në operatin kadastral.

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë bën përtërirjen e pjesëve të vjetruara ose të tërë operatit kadastral dhe kujdeset për hartimin me kohë të riprodhimeve të reja, të origjinaleve të vjetruara ose të dëmtuara të punës.

Kur organi komunal kompetent për punët e gjeodezisë gjatë mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave përtërinë operatin kadastral ka për detyrë që të veprojë sipas mënyrës së parashikuar në nenin 59, paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 62

Shfrytëzuesi i tokës ka për detyrë që organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë t'ia paraqesë çdo ndryshim të gjendjes poseduese, të kulturave, të ndërtimit ose të mënjanimi të objekteve ndërtimore dhe të objekteve tjera, si dhe ndryshimin i cili ndikon në caktimin e klasës, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë.

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë do t'i marrë në procedurë, sipas detyrës zyrtare, ndryshimet nga paragrafi 1 i këtij neni për të cilat është njohur edhe në mënyrë tjetër.

Neni 63

Kur ka të bëjë me ndërtimin e rrugëve, të hokurudhave, të kanaleve, të ndërtesave ose të objekteve tjera në pronësinë shoqërore, e me këtë ndërtim ose rikonstruim ndikohet në të dhënat e shë-

nuara në operatin dhe në planet kadastrale, organizata e punës së bashkuar, organizata e bashkësisë vetëqeverisëse dhe organizata tjetër, e cila kujdeset për ndërtimin ose mirëmbajtjen e këtyre objekteve, ka për detyrë që, pas ndërtimit ose rikonstruimit të kryer, bashkangjitur me fletëparaqitje nga neni 62 paragrafi 1 të këtij ligji, t'ia paraqesë organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë elaboratin e matjes në bazë të të cilit ndryshimet e bëra mund të inkorporohen në planet dhe në operatin kadastral.

Neni 64

Shfrytëzuesi i tokës në të cilën janë bërë ndryshime dhe në bartjen e të cilave në plan dhe në operatin kadastral është e nevojshme të bëhet rilevimi i ri, ka për detyrë që me shpeztizime të veta t'i shënojë kufijtë e tokës së vet me figura të dukshme dhe të përhershme.

Neni 65

Çdo vit në kohën prej 1 maj deri më 31 tetor organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë ka për detyrë të bëjë kontrollimin aty për aty ose rilevimin sipas fletëparaqitjeve, përkatësisht ndryshimeve të bëra nga neni 62 paragrafi 1 të këtij ligji që kanë arritur deri më 1 maj të vitit vijues.

Në qoftë se organi komunal i administratës, kompetent për punët e gjeodezisë, me rastin e kryerjes së punëve nga paragrafi 1 i këtij neni vërteton se në terren janë bërë ndryshime të cilat nuk janë paraqitur, do të bëjë kontrollimin ose rilevimin e veçantë për ato.

Neni 66

Ndryshimet për të cilat është bërë kontrollimi aty për aty ose rilevimi, si dhe ndryshimet sipas fletëparaqitjeve për të cilat nuk është e nevojshme të bëhet kontrollimi aty për aty ose rilevimi, që kanë arritur deri më 31 dhjetor të vitit vijues, duhet të barten në planet dhe në operatin kadastral deri më 15 mars të vitit të ardhshëm.

Baza për ndryshimin e shfrytëzuesit të tokës në operatin kadastral është vendimi i plotëfuqishëm i gjykatës ose i organit tjetër kompetent dhe kontrata e vërtetuar në gjykatë në qoftë se i përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë merr aktvendim për të gjitha ndryshimet e barta në origjinalet e punës dhe në operatin kadastral dhe ia dërgon shfrytëzuesit të tokës.

Derisa të barten ndryshimet në operatin kadastral, si e saktë merret gjendja në operatin kadastral.

Neni 67

Ndryshimet të cilat nuk janë bërë në pajtim me dispozitat në fuqi nuk mund të barten në origjinalet e punës dhe në operatin kadastral, por evidentohe në origjinalet e punës.

Neni 68

Së paku në çdo dhjetë vjet organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë ka për detyrë që aty për aty të kontrollojë rregullsinë e gjendjes së regjistruar në origjinalet e punës dhe në operatin kadastral.

Kontrollimi sipas mënyrës nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përfshijë disa ose të gjitha të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave.

Të gjitha ndryshimet e konstatuara me rastin e kontrollimit konsiderohen si ndryshime të vërtetuara sipas detyrës zyrtare.

IV. PËRTRIRJA E MATJES DHE E KADASTRIT TË TOKAVE

Neni 69

Përtrirja e matjes dhe e kadastrit të tokave bëhet kur të shfaqet mospajtim i dukshëm midis të dhënave të matjes e të operatit kadastral dhe gjendjes në terren e të cilat nuk mund të mënjanojnë me masat e mirëmbajtjes së rregullt.

Përtrirja e matjes dhe e kadastrit të tokave përfshin rimatjen, klasifikimin e sërishëm kadastral dhe bonitimin e sërishëm të tokave, si dhe hartimin e operatit të ri kadastral. Përfshitimisht, mund të bëhet vetëm përtrirja e klasifikimit kadastral dhe bonimi i tokave, në qoftë se nuk ka nevojë për rimatje.

Përtrirja e matjes dhe e kadastrit të tokave domosdo bëhet me rastin e zbatimit të komasacionit të tokave në pjesët e komunës kadastrale, të cilat nuk janë inkorporuar në masën e komasacionit.

Përfshitimisht nga paragrafi 3 i këtij neni përtrirja nuk do të bëhet në pjesën e cila nuk është inkorporuar në masën e komasacionit, në qoftë se kjo pjesë përbënë 2/3 e më tepër të territorit të komunës kadastrale.

Neni 70

Vendimin për përtrirjen e kadastrit të tokave e merr Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 71

Mjetet për përtrirjen e matjes dhe të kadastrit të tokës i siguron Krahina.

Përfshitimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, mjetet për përtrirjen e matjes dhe të kadastrit të tokave i siguron komuna:

a) në qoftë se mospajtimi i dukshëm midis të dhënave të matjes dhe operatit kadastral me gjendjen në terren është shfaqur për shkak se organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë nuk e ka kryer rregullisht mirëmbajtjen e matjes dhe të kadastrit të tokave për ç'arsye është zvogëluar dukshëm mundësia e shfrytëzimit të mëtejme të tyre, dhe

b) në qoftë se kuvendi i komunës për shkaqe të veçanta kërkon përtrirjes e matjes dhe të kadastrit të tokave.

Neni 72

Rezultatet e përtërirjes së matjes dhe të kadastrit të tokave ekspozohen për shikim publik në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar në nenet 52 deri në 57 të këtij ligji.

V. PUNËT E GJEODEZISË PËR NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 73

Punë të gjeodezisë për nevojat e veçanta në pajtim me këtë ligj konsiderohen punët e dedikuara për nxjerrjen e të dhënave të gjeodezisë për planet urbanistike, për planet e rregullimit dhe të nivelimit, për punë hidrobnike, për trasimin e rrugëve, të vijave hekurudhore, të kanaleve, të largëpërçuesve, për ekspropriimin e tokave, për aronimin e tokave, për rajonet e fushave xehtare, për komplekset pyjore dhe bujqësore, si dhe me rastin e punëve të bartjes në terren të planeve urbanistike dhe të projekteve të vendbanimeve të reja.

Punët nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kryhen në mënyrë që të dhënat e nxjerra të mund të shfrytëzohen për nevojat e hartimit, të përtrirjes ose të mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave.

Neni 74

Organel, organizatat e punës së bashkuar, organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, për nevojat e veta mund t'i kryejnë punët nga neni 73 i këtij ligji vetëm nëpërmjet personit profesional, i cili, së paku, ka të kryer kualifikimin e mesëm shkollor të gjeodezisë dhe provimin e dhënë profesional sipas programit të përcaktuar për punëtorët në organet e administratës.

Organel, organizatat e punës së bashkuar, organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, në kuadër të veprimtarisë së vet mund t'i kryejnë punët e gjeodezisë nga neni 73 i këtij ligji në qoftë se në pikëpamje të pajimeve dhe të kuadrove e plotësujnë kushtet e përcaktuara në nenin 90 të këtij ligji.

Neni 75

Organel, organizatat e punës së bashkuar, organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse para se t'ia fillojnë punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta nga neni 73 paragrafi 1 të këtij ligji kanë për detyrë që së paku 15 ditë më parë ta njoftojnë për këtë organin komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë në territorin e të cilit do t'i zhvillojnë këto punë.

Fletëparaqitja nga paragrafi 1 i këtij neni përmbanë të dhënat për rajonin në të cilin do të kryhen punët e gjeodezisë, për përmbajtjen, mënyrën dhe qëllimin e kryerjes së punëve dhe për datën e fillimit dhe afatin e parashikuar për zgjatjen e këtyre punëve, emrat dhe kualifikimin profesional të punëtorëve të cilët do të bëjnë matjen.

Neni 76

Në qoftë se rajoni në të cilin do të bëhet matja përfshin pjesët e territoreve të dy ose më tepër komunave, fletëparaqitja nga neni 75 i këtij ligji i paraqitet organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë të asaj komune, territori i së cilës përfshin pjesën më të madhe të tokës në të cilën bëhet matja.

Organi nga paragrafi 1 i këtij neni ka për detyrë që brenda afatit prej tri ditësh t'i informojë për pranimin e fletëparaqitjes dhe përmbajtjen e saj organet komunale të administratës kompetente për punët e gjeodezisë të komunave tjera në territorin e të cilave do të bëhet paraqitja e matjeve.

Neni 77

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë ka për detyrë që menjëherë ta informojë Drejtorinë Krahinore të Gjeodezisë për fletëparaqitjet nga neni 75 i këtij ligji.

Neni 78

Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë, përkatësisht organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë para fillimit të punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta, mund të marrë aktvendim për zgjerimin e vëllimit dhe llojin e punëve me qëllim që të dhënat e nxjerra të shfrytëzohen për matje e kadastrë dhe për mirëmbajtjen e tyre.

Ankesa kundër këtij aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e shtyn afatin e zbatimit të aktvendimit.

Mjetet për vëllimin e zgjeruar dhe llojin e punëve i siguron bashkësia shoqërore-politike, organi i së cilës ka marrë aktvendim nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 79

Aktvendimi i Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë, përkatësisht aktvendimi i organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë nga

neni 78 paragrafi 1 i këtij ligji duhet të merret brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e arritjes së fletëparaqitjes për fillimin e punëve të matjes.

Neni 80

Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë, përkatësisht organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë ka të drejtë të mbikëqyrë të gjitha punët e gjeodezisë që kanë të bëjnë me matjen dhe nëse vërteton se këto punë nuk po kryhen sipas dispozitave në fuqi mund të kërkojë që të metat e konstatuara të mënjahohen brenda afatit të caktuar.

Organi, përkatësisht organizata nga neni 74 i këtij ligji që bën matjen dhe nuk vepron sipas aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë, përkatësisht organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë mund të marrë aktvendim për ndërprerjen e kryerjes së mëtejme të punëve.

Ankesa kundër këtij aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e shtyn afatin e zbatimit të tij.

Neni 81

Organet, organizatat e punës së bashkuar dhe organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, të cilat kryejnë punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta kanë për detyrë që brenda afatit prej 30 ditësh pas kryerjes së këtyre punëve t'ia dërgojnë origjinalet e planeve, përkatësisht të hartës, si dhe tërë elaboratin për matjen e kryer organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë.

Organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë pas pranimit të punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, në qoftë se nuk ka të bëjë me vëllimin më të madh, do të bëjë kontrollimin dhe vërtetimin e planeve dhe të elaborateve brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të elaboratit.

Në qoftë se punët nga paragrafi 1 i këtij neni janë të një vëllimi më të madh, organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë do t'ia dërgojë planet dhe elaboratin me mendimin e vet Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë, e cila brenda afatit prej 30 ditësh do të bëjë kontrollimin dhe vërtetimin e planeve dhe të elaboratit.

Neni 82

Elaborati, planet dhe hartat për punët e gjeodezisë nga neni 73 i këtij ligji nuk mund të shfrytëzohen derisa të mos i vërtetojë Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë, përkatësisht organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 81 paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 83

Organet, organizatat e punës së bashkuar dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse (në tekstin e mëtejme: investuesi), për nevojat e të cilat janë kryer punët e gjeodezisë nga neni 73 i këtij ligji ka për detyrë që pa kompensim t'ia dorëzojë organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë origjinalet e planeve dhe elaboratin e punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta, me qëllim të shfrytëzimit, përtirjes dhe mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave.

Investuesit të cilët i kanë dorëzuar të dhënat e punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta nga paragrafi 1 i këtij neni këto të dhëna mund t'i shfrytëzojnë për nevojat e veçanta pa kompensim.

Neni 84

Sipas dispozitave të neneve 73 — 85 të këtij ligji veprojnë edhe organizatat e gjeodezisë kur t'i kryejnë punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta.

VI. KOMPETENCA DHE MARRËDHËNIET

Neni 85

Punët e matjes dhe të hartimit të kadastrit të tokave janë në kompetencë të Krahinës.
Punët e mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave janë në kompetencë të komunës.

Neni 86

Punët administrative nga neni 85 paragrafi 1 të këtij ligji i kryen Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë.
Punët administrative nga neni 85 paragrafi 2 të këtij ligji i kryen organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë.

Neni 87

Drejtorja Krahinore e Gjeodezisë ndaj organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë ka të drejtë:

1. të bëjë kontrollimin e mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave dhe në qoftë se konstaton se këto punë nuk kryhen në pajtim me dispozitat në fuqi të vëjë në dukje të metat e vërejtura dhe të caktojë afatin brenda të cilit këto të meta duhet të mënjahohen,

2. t'i qesë jashtë përdorimit origjinalet e punës dhe operatin kadastral, në qoftë se konstaton se në to ka të meta të mëdha, derisa të mënjahohen ato.

Neni 88

Drejtorja Krahinore e Gjeodezisë ndaj organizatave të gjeodezisë përveç të drejtave nga neni 87 paragrafi 1 të këtij ligji ka edhe të drejtë të ndërpresë punën e mëtejme në matjen dhe në hartimin e kadastrit të tokave në qoftë se konstaton se matja dhe kadastrit i tokave nuk kryhet në pajtim me këtë ligj, si dhe të drejtë që të ndalojë shfrytëzimin e të dhënave të cilat janë rezultat i punëve të kryera jo në rregull në terren.

Të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni ka edhe organi komunal i administratës, kompetent për punët e Gjeodezisë ndaj organizatës gjeodete të cilës i ka ~~qendër~~ punimet për kryerjen e matjes dhe të përpilimit të kadastrës së tokës.

Neni 89

Eprori i Drejtorisë gjeodete krahinore nxjerr dispozita për normativat teknike, metodat dhe mënyrën e punës që aplikohen me rastin e kryerjes së matjes e të hartimit të kadastrit dhe mirëmbajtjes së tij, si dhe lidhur me kryerjen e punëve për nevojat e veçanta.

Me dispozitat e këtij neni sigurohet aplikimi konsequent i parimit të barabarësisë së gjuhëve e të shkrimeve.

VII. ORGANIZATAT E PUNËS SË BASHKUAR TË GJEODEZISË

Neni 90

Organizata e gjeodezisë nuk mund t'i kryejë e as nuk mund t'i cedohen punët e gjeodezisë në qoftë se nuk i plotëson këto kushte:

— të ketë siguruar pajimin përkatës dhe
— të ketë së paku tetë punëtorë të degës së gjeodezisë me provim të dhënë profesional, nga të cilët së paku tre duhet të jenë inxhinierë të gjeodezisë, përkatësisht inxhinierë të diplomuar të gjeodezisë.

Drejtorja Krahinore e Gjeodezisë konstaton se a janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 91

Në qeverisje me punë me interes të veçantë shoqëror në organizatën e gjeodezisë marrin pjesë edhe përfaqësuesit e bashkësisë shoqërore.

Përbërja dhe numri i përfaqësuesve të bashkësisë shoqërore përcaktohet me statutin e organizatës së gjeodezisë.

Neni 92

Themeluesi i organizatës së gjeodezisë jep pëlqimin: për dispozitat e statutit dhe të marrëveshjes vetëqeverisëse mbi bashkimin në organizatën e gjeodezisë, të cilat janë me rëndësi për realizimin e interesit të veçantë shoqëror në kryerjen e veprimtarisë së organizatës dhe për dispozitat e statutit të cilat kanë të bëjnë me përbërjen dhe numrin e përfaqësuesve të bashkësisë shoqërore të qeverisjes me organizatën e gjeodezisë, për dispozitat e marrëveshjes vetëqeverisëse me të cilat rregullohet mënyra e vendosjes së çështjeve me interes të veçantë shoqëror në organizatën e gjeodezisë, për vendimin e emërimit dhe të shkarkimit të organit individual punëdrejtues të organizatës së gjeodezisë.

Neni 93

Organizata e gjeodezisë së cilës i janë ceduar punët për kryerjen e matjes dhe të hartimit të kadastrit të tokave, ka për detyrë, kur t'i kryejë punët, t'ia dorëzojë Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë origjinalet e planeve dhe të hartës me elaboratin e tërësishtëm të gjeodezisë, operalin kadastral dhe të dhënat e caktuara të klasifikimit kadastral dhe të bonitimit të tokave.

Neni 94

Drejtorija Krahinore e Gjeodezisë ndaj organizatës së gjeodezisë e cila i zhvillon punët në kryerjen e matjes dhe të hartimit të kadastrit të tokave i ka këto të drejta dhe detyra:

1. të bëjë mbikëqyrjen e punëve në kryerjen e matjes dhe të hartimit të kadastrit të tokave,
2. të ndërpresë punën e mëtejme në kryerjen e matjes dhe të hartimit të kadastrit, në qoftë se organizata e gjeodezisë e cila i kryen punët brenda afatit të caktuar nuk i mënjanon të metat e vërejtura, dhe

3. të ndalojë shfrytëzimin e të dhënave të matjes dhe të kadastrit të tokave, të cilat janë rezultat i punëve të kryera jo në rregull në terren.

Të drejtat dhe detyrat nga paragrafi 1 i këtij ligji i ka edhe organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë ndaj organizatës së gjeodezisë së cilës ia ka ceduar punët e mirëmbajtjes së matjes dhe të kadastrit të tokave.

VIII. KOMPENSIMET PËR KRYERJEN E SHËRBI-MEVE DHE SHFRYTËZIMIN E TË DHËNAVE TË MATJES DHE TË KADASTRIT TË TOKAVE

Neni 95

Organi, organizata e punës së bashkuar, organizata e bashkësisë tjetër vetëqeverisëse dhe qytetarët të cilët i shfrytëzojnë të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave kanë për detyrë të paguajnë kompensimin për shfrytëzimin e të dhënave.

Neni 96

Vendimin për lartësinë e kompensimit për shërbimet që i kryen Drejtorija Krahinore e Gjeodezisë e merr Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Vendimin për lartësinë e kompensimit për shërbimet të cilat i kryen organi komunal i administratës për punët e gjeodezisë e merr kuvendi i komunës.

Kuvendet e komunave me marrëveshje mund të përcaktojnë lartësinë unike të kompensimit për kryerjen e shërbimeve.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni caktohet në mënyrë që me të të mbulohen shpenzimet reale të shërbimit dhe të amortizimit të mjeteve të përdorura.

Neni 97

Drejtorija Krahinore e Gjeodezisë bënë pagesën e kompensimeve për shërbimet që u kryen organeve, përkatësisht organizatave nga neni 95 i këtij ligji.

Kompensimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk paguhet në qoftë se për kompensimin në fjalë parashikohet pagesa e taksave administrative ose me dispozitë të veçantë është caktuar që shërbimi të kryhet sipas detyrës zyrtare.

Neni 98

Mjetet e realizuara, duke i paguar shërbimet e kryera evidentohen në llogari të veçantë të Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë dhe shfrytëzohen për kryerjen e matjes dhe të kadastrit të tokave, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të shërbimeve.

IX. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 99

Organizata e punës së bashkuar, organizata dhe bashkësia vetëqeverisëse dhe organizata tjetër, do të dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 5.000 deri 50.000 dinarë:

1. në qoftë se kopjen, përshkrimin ose ndonjë të dhënë tjetër të matjes dhe të kadastrit të tokave ia cedon organit tjetër, organizatës së punës së bashkuar dhe qytetarëve pa pëlqimin e organit për punë të gjeodezisë për dhënien e këtyre të dhënave (neni 10 paragrafi 3),

2. në qoftë se punët lidhur me pasuritë e paluajshme për të cilat nevojiten të dhënat e matjes dhe përshkrues nuk i shfrytëzon të dhënat e matjes dhe të kadastrit të tokave (neni 12 paragrafi 1),

3. në qoftë se vërteton planin, kopjen ose elaboratin e gjeodezisë, i cili nuk është hartuar sipas dispozitave në fuqi (neni 25 paragrafi 1),

4. në qoftë se brenda afatit të caktuar nuk i shënon me figura të dukshme dhe të përherëshme kufijtë e tokave dhe të objekteve që gjenden në to (neni 27),

5. në qoftë se nuk u lejon hyrjen personave të cilët punojnë në punët e matjes, të kadastrit të tokave ose të mirëmbajtjes së tij ose nuk lejon që këta persona t'i vendosin figurat dhe shenjat me të cilat i shënojnë pikat e matjes (neni 28 paragrafi 3),

6. në qoftë se e asgjëson, e dëmton ose e transferon figurën ose shenjën, përkatësisht në qoftë se për asgjësimin, dëmtimin, shtryerjen ose transferimin nuk e informon organin komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë (neni 31 paragrafi 2),

7. në qoftë se brenda afatit të përcaktuar nuk e informon organin komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë për kryerjen e punëve ndërtimore ose të punëve tjera, të cilat mund të dëmtojnë ose të asgjësojnë figurën ose të zvogëlojnë mundësinë e shfrytëzimit të saj (neni 32),

8. në qoftë se brenda afatit të përcaktuar nuk i paraqet organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë ndryshimin e bërë në tokë ose në objekt (neni 62 paragrafi 1),

9. në qoftë se organi komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë nuk i paraqet elaboratin e matjes pas kryerjes së ndërtimit ose rikonstruimit të objektit (neni 63),

10. në qoftë se me figura të dukshme dhe të përherëshme nuk i shënon kufijtë e tokës së vet në të cilën janë bërë ndryshimet (neni 64),

11. në qoftë se punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta nuk i kryen në atë mënyrë që të dhënat e nxjerra të mund të shfrytëzohen për nevojat e hartimit, të përtirjes ose të mirëmbajtjes së matjes së kadastrit të tokave (neni 73 paragrafi 2),

12. në qoftë se punët për nevojat e veta i kryen pa personin profesional (neni 74 paragrafi 1),

13. në qoftë se në kuadër të veprimtarisë së vet i kryen punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta pa pajime përkatëse ose kuadro (neni 74 paragrafi 2),

14. në qoftë se organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë brenda afatit të përcaktuar nuk ia paraqet fillimin e punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta (neni 75 paragrafi 1),

15. në qoftë se organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë brenda afatit të përcaktuar pas kryerjes së punëve të gjeodezisë për nevojat e veçanta nuk ia dërgon pasqyrën dhe vërtetimin e origjinaleve të planit, të hartës dhe të elaboratit (neni 81 paragrafi 1),

16. në qoftë se planet, hartën ose të dhënen tjetër për punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta i shfrytëzon para se këto t'i vërtetojë organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë, përkatësisht Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë (neni 81 paragrafi 2 dhe 3),

17. në qoftë se organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë nuk ia dorëzon origjinalet e planit dhe elaboratin për punët e gjeodezisë për nevojat e veçanta (neni 83 paragrafi 1),

18. në qoftë se i zhvillon punët ose i cedon punët kundër kushteve (nga neni 90 i këtij ligji),

19. në qoftë se pas kryerjes së punëve të matjes ose të hartimit të tokave nuk ia dorëzon Drejtorisë Krahinore të Gjeodezisë origjinalet e planit — të hartës me elaboratin e tërësishëm (neni 93),

20. në qoftë se nuk vepron sipas aktvendimit të Drejtorisë krahinore të Gjeodezisë, përkatësisht të organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë (neni 94).

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 1-20 të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar dhe në organizatën dhe bashkësinë tjetër vetëqeverisëse me gjobë deri në 5.000 dinarë.

Neni 100

Qytetari — shfrytëzuesi i tokës do të dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 500 deri 5.000 dinarë.

1. në qoftë se brenda afatit të caktuar nuk i shënon me figura të dukshme dhe të përhershme kufijtë e tokës dhe objektet që gjenden në to (neni 27),

2. në qoftë se nuk u lejon hyrjen personave të cilët punojnë në punët e matjes, të kadastrit të tokave dhe të mirëmbajtjes së tij ose në qoftë se nuk lejon që këta persona t'i vendosin figurat dhe shenjat me të cilat i shënojnë pikat e matjes (neni 28 paragrafi 3),

3. në qoftë se e asgjëson, e dëmton, e bart ose e transferon figurën ose shenjën, përkatësisht në qoftë se pas asgjësimit, dëmtimit, bartjes ose transferimit nuk e informon organin komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë (neni 31 paragrafi 2),

4. në qoftë se brenda afatit të përcaktuar nuk ia paraqet organit komunal të administratës kompetent për punët e gjeodezisë ndryshimin e bërë në tokë ose në objekt (neni 62 paragrafi 1),

5. në qoftë se me figura të dukshme dhe të përhershme nuk i shënon kufijtë e tokës së vet në të cilën janë bërë ndryshimet (neni 64).

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 101

Në rajonet në të cilat ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfrytëzohen operatet kadastrale të regjistrimit do të kryhet matja dhe hartimi i kadastrit të tokave deri në fund të vitit 1984.

Neni 102

Kufijtë dhe emrat e komunave kadastrale ekzistuese dhe të rretheve kadastrale të formuara sipas dispozitave të deritashme mbeten në fuqi dhe mund të ndryshohen vetëm në mënyrën dhe sipas procedurës së parashikimit me këtë ligj.

Neni 103

Derisa të kryhet matja dhe hartimi i kadastrit të tokave sipas dispozitave të këtij ligji në rajonet në të cilat është kryer matja dhe është hartuar kadastrit i tokave në bazë të dispozitave të mëparshme, si dhe në rajonet në të cilat është kryer kadastrit i regjistruar i tokave, do të shfrytëzohet matja ekzistuese dhe kadastrit i tokave, përkatësisht kadastrit i regjistrimit të tokave.

Neni 104

Në punët e matjes që nuk janë kryer deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 105

Dispozitat nga neni 89 i këtij ligji do të nxirren brenda afatit prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 106

Derisa të nxirren dispozitat nga neni 105 i këtij ligji do të zbatohen dispozitat të cilat kanë qenë në fuqi deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 107

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Ligji i matjes dhe i kadastrit të tokave («Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës», nr. 12/73).

Neni 108

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në «Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës».

